



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Komuna Klinë

Zyra e Kryetarit të Komunës

01 Nr. 06-33736/23
Klinë, datë: 25.10.9. 2023

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik me banorët e fshatrave Shtupel, Kërrnicë, Binxhë, Grabc, Dranashiq (komunitetin joshumicë), i cili u mbajt në hapësirat e shkollës së mesme "Avni Zhabota" në fshatin Shtupel, me datë 9 gusht 2023 dhe filloj në orën 18:00, ku morën pjesë: 28 persona.

RENDI I DITES

1. DRAFT PLANI I BUXHETIT KOMUNAL I KLINËS 2024 – 2026

Komuna e Klinës ka vazhduar me debatet me banorët e fshatrave Shtupel, Kërrnicë, Binxhë, Grabc, Dranashiq, banorë nga komuniteti joshumicë, në hapësirat e shkollës së mesme të ulët "Avni Zhabota".

Për pikën e rendit të ditës draft-plani i buxhetit komunal i Klinës 2024 – 2026, fjalën hyrëse e mori kryetari i komunës, Prof. Dr. Zenun Elezaj i cili ishte i shoqëruar nga drejtori i drejtorisë së Financave, z. Enver Berisha, drejtorë të tjerë të drejtorive si dhe grupei punues për organizimin e dëgjimeve buxhetore.

Ai së pari foli për investimet të cilat pritet të realizohen brenda këtij viti në fshatin Shtupel e që janë në fazën e prokurimit publik asfaltimi i rrugëve lokale Shtupel - Kërrnicë si dhe shtrimi i rrjetit të kanalizimit në Kërrnicë - Shtupl - Binxhë me një vlerë deri në 130 mijë euro. Ndërsa, informoi banorët e fshatit Shtupel që gjithashtu, shumë shpejtë brenda vitit do të filloj edhe ndërtimi i trotuarit me ndriçim.

Pas kryetarit, përfaqësuesi i drejtorisë së Financave, z. Ajet Sejdiu, ju dha fjalën pjesëmarrësve për të diskutuar lidhur me atë që u prezantua nga ana e kryetarit Elezaj si dhe ndarjen e

nevojave dhe kërkesave apo edhe ndarjen e sugjerimeve që ata kanë lidhur me buxhetin e viti 2024.

DISKUTIMET DHE KËRKESART

Arsim Dallaveraj – Banorë i fshatit Shtupel, falënderoi kryetarin Elezaj për të gjitha investimet që janë bërë në fshatin Shtupel e në veçanti për projektet e reja që do të realizohen. Ai kërkoi që në rrugën kryesore të fshatit të ndërtohet një park i vogël me ulëse dhe gjelbërim - drunjëtë dekorativ të mbillen të cilin mund ta shfrytëzojnë banorët për qëndrim ditor dhe pushim apo edhe fëmijët për lojë.

Brahim Temaj – Banorë i fshatit Shtupel, gjithashtu si parafolësi i tij kërkon një park sado i vogël të ndërtohet në fshatin Shtupel, pasi që tani do të ndërtohen edhe rrugët e reja, ky park do të shfrytëzohej nga shumë persona.

Ismet Imeraj – Banorë i fshatit Shtupel, përshëndeti të pranishmit dhe parashtroi kërkesën që në lagjen “Imeraj”, ku ai jeton kërkon shtrimin me zhavorr të një rrugice të paktën, nëse nuk ekziston mundësia që ato pak metra të asfaltohen atëherë një shtresë zhavorr do të mjaftonte. Gjithashtu të shikohet mundësia që në projektin e ri të kanalizimit, lagja “imeraj” të mos mbetët jashtë kyçjes në këtë shtrirje.



Blerim Temaj – Banorë i fshatit Shtupel, falënderoi kryetarin për pjesëmarrije çdo herë që viziton fshatin Shtupel si dhe projektet që ka realizuar deri më tani. Ai shprehi si kërkesë sigurimin apo furnizimin e rregullt me ujin e pijes për lagjen “Temaj” si dhe lagjen “Sylaj”, pasi që ka reduktime të shumta deri në dy javë, andaj theksoi se ekziston nevoja të paktën për pastrimin e një bunari që gjendet afér e që ka ujë mjaftueshëm në mënyrë që të shfrytëzojë për amvisëri nga banorët e këtyre dy lagjeve.

Edmond Kerellaj – Banorë i fshatit Shtupel, Kanalizimi në lagjen “Kerellaj” të përfundohet pasi ka mbetur në gjysmë si dhe asfaltimin e rrugicës së “Qakollëve”.

Skender Qakolli – Banorë i fshatit Shtupel, po ashtu kërroi asfaltimin e një rrugice e cila gjendet në lagjen e “Qakollëve”.

Muhamed Dautaj – Banorë i fshatit Shtupel, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, përgëzoi kryetarin Elezaj për të gjitha investimet në fshatin Shtupel. Ai parashtroi si nevojë punësimin e disa të rinjve apo personave nga ky fshat pasi shumë prej tyre dhe shumë familje nuk kanë asnjë të ardhur apo mbështetje financiare.

Mujë Kerellaj – Banorë i fshatit Shtupel, kërroi nga që në rrugën kryesore të vendosen polic të shtrirë apo shenjëzim për kufizim të shpejtësisë pasi që për ne si banorë është shqetësuese dalja e fëmijëve tanë në rrugë apo kur shkojnë në shkollë nga vozitja e disa personave me automjete me tejkalim të shpejtësisë.

Takimi përfundoi në orën 19:13.

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	0
Meshkuj	28
Total:	28

Procesmbajtëse:

Vlora Tafili

Klinë, datë:

